

MASTER

PROFESIONAL 120 ECTS NË

ADMINISTRIM BIZNESI

Me profil **Financë-Kontabilitet**
dhe me profil **Menaxhim**

THELLO DIJET,

GARANTO

PROFESIONIN!

Kohëzgjatja: : **4 semestra**

Gjuha: **Shqip**

Fakulteti i: **Biznesit dhe Drejtësisë**

Skano
për më
shumë
info





Të nderuar studentë,
Si Shefi i Departamentit të Biznesit dhe Financës, kam kënaqësinë t'iu uroj mirëseardhjen në programin Profesional të Masterit në Administrim Biznesi. Ky program prej 120 ECTS është projektuar për t'iu ofruar njohuri të gjera dhe aftësi të avancuara, të cilat janë thelbësore për të pasur sukses në mjedisin konkurrues të sotëm të biznesit. Gjatë studimeve tuaja, Ju do të angazhoheni në një kurrikulë dinamike që kombinon bazat teorike me aplikime praktike në fusha të ndryshme të biznesit, duke përfshirë financën, strategjinë, udhëheqjen dhe inovacionin.

Fakulteti ynë është i përkushtuar të ofrojë një përvojë

akademike rigorozë dhe të pasur, dhe ne jemi këtu për t'ju mbështetur ndërsa ndiqni objektivat tuaja akademike dhe profesionale.

Përveç lëndëve kryesore, ju inkurajojmë të përfitonit nga mundësitë e rrjetëzimit, praktikave profesionale dhe bashkëpunimi me liderë të industrisë, të cilat janë pjesë integrale e programit tonë. Këto eksperiencë do të thellojnë kuptimin tuaj të praktikave globale të biznesit dhe do t'ju përgatisin për të qenë liderë në fushën tuaj.

Jemi të emocionuar që do të udhëtojmë së bashku në këtë rrugëtim dhe mezi presim të shohim perspektivat dhe talentet unike që do të sillni në komunitetin tonë akademik. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për mbështetje gjatë programit, mos hezitoni të kontaktoni me mua ose me cilindo nga pedagogët tanë. Ne jemi këtu për të mbështetur suksesin tuaj.

Ju uroj një vit akademik produktiv dhe të suksesshëm!

Me respekt,

Dr. Gerti Dajçi

Shef i Departamentit të Biznesit dhe Financave

Programi Profesional i Masterit në Administrim Biznesi 120 ECTS

Tirana Business University

PËRMBLEDHJE E PROGRAMIT

Programi Profesional i Masterit në Administrim Biznesi (MBA) është një program i avancuar studimesh që synon të përgatisë profesionistë të aftë për të udhëhequr dhe menaxhuar në sektorë të ndryshëm të biznesit global. Ky program ofron një bazë të gjerë teorike dhe praktike në fusha kyçe të administrimit të biznesit, si financa, strategjia, marketingu, udhëheqja dhe menaxhimi i inovacionit. Qëllimi i programit është të përgatisë në kohë të shkurtër profesionistë në fushën e menaxhimit dhe kontabilitet-financës të aftë të marrin përsipër menaxhimin dhe drejtimin në subjekte të ndryshme biznesi, por dhe në sektorë të tjerë, si sektori publik dhe tjetër jofitimprurës.

Objektivi kryesor i programit të studimit Master Profesional në Administrim - Biznesi me 120 kredite (ECTS), me profile: "Menaxhim" dhe "Kontabilitet-Financë", është të përgatisë administratorë të përgjithshëm, apo menaxherë si dhe administratorë të profilizuar në aspekte më specifike, si: financë - kontabiliteti dhe menaxhim, të pajisur me njohuritë teorike të një niveli më të lartë, shoqëruar me shprehje praktike më të gjera për t'i bërë ata të aftë të kuptojnë kërkesat, kushtet dhe zhvillimet e tregut specifik ku konkurren biznesi, të mjedisit ekonomik dhe më të aftë për të hyrë në këtë treg.

DALLIMI KRYESOR NË PROGRAMIN MASTER SHKENCOR NË ADMINISTRIM BIZNESI 120 ECTS ËSHTË SE OFRON:

1. PËRVOJA GJITHËPËRFSHIRËSE TË TË NXËNIT

Zakonisht zgjat dy vjet, duke siguruar një eksplorim më të thellë të disiplinave të biznesit. Lejon një gamë më të gjerë lëndësh zgjedhore dhe specializimesh, duke u kujdesur për qëllime të ndryshme të karrierës.

2. PROJEKTET KËRKIMORE

Shpesh përfshin një komponent të rëndësishëm kërkimor ose një projekt themelor, duke rritur aftësitë e të menduarit analitik dhe strategjik. Ofron mundësi për të punuar në sfidat komplekse të biznesit.

3. POTENCIALI MË I MADH I RRJETËZIMIT

Kohëzgjatja e zgjatur lejon marrëdhënie më të thella me kolegët, fakultetin dhe profesionistët e industrisë, të cilat mund të rrisin mundësitë e karrierës.

4. MUNDËSI TË RRITURA PËR KARRIERË


Koha shtesë e kaluar në program mund të sigurojë një avantazh konkurrues në tregun e punës, veçanërisht për rolet menaxheriale dhe drejtuese.

5. ZHVILLIMI I AFTËSIVE TË BUTA (SOFT SKILLS)

Programet më të gjata shpesh theksojnë aftësitë e buta si lidershipi, komunikimi dhe puna ekipore, të cilat janë vendimtare për suksesin menaxherial. Programi 120 ECTS ofron një përvojë më gjithëpërfshirëse arsimore që përgatit studentët për role udhëheqëse të nivelit më të lartë.

PËRFITIMET

Pjesëmarrja në këtë program ofron një sërë përfitimesh të rëndësishme që do t'ju përgatisin për një karrierë të suksesshme dhe dinamike në botën e biznesit:



PERSPEKTIVAT E PUNËSIMIT TË HAPURA NGA MASTERI PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI

Me programin Master Profesional në Administrim Biznesi ju mund të punësoheni në:

- Administratë Publike, qendrore dhe vendore, si specialistë dhe drejtues financiarë, të burimeve njerëzore marrëdhënies me publikun, prokurimeve, menaxhimit të projekteve, etj;
- Sektorin privat, si: specialistë dhe drejtues të financës, kontabilitetit, auditit, burimeve njerëzore, marketingut, shitjeve, marrëdhënies me klientin, menaxhimit të cilësisë, etj;
- Organizata jofitimprurëse, si: specialistë, drejtues dhe vlerësues projektsh, etj;

Ju përgatiteni për:

- Drejtor Financiar (CFO);
- Menaxher i Përgjithshëm;
- Konsulent Biznesi;
- Drejtor Marketingu;
- Drejtor i Burimeve Njerëzore;
- Drejtues Operacionesh;
- Menaxher Projekti;
- Menaxher Produkti;
- Këshilltar për Zhvillimin Strategjik;
- Sipërmarrës.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i Masterit ofron një kurrikulë të gjerë prej 120 kredites ECTS që mbulon disa fushat kyçe për funksionimin dhe menaxhimin efikas të bizneseve. Ai përfshin 8 lëndë në semestrin e parë dhe 7 lëndë në semestrin e dytë, ndërsa kreditet e tjera fitohet përmes praktikës profesionale dhe provimit të diplomimit.

AFTËSITË E ZHVILLIMIT PERSONAL DHE NDËRPERSONAL
Mendimi kritik
Njohuri të avancuara në profilet e menaxhimit, kontabilitetit dhe financës
Aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të administrimit
Aftësi në kërkimin, zhvillim apo inovacion
Vendimmarrje
Analizë të dhënash

METODA E

MËSIMDHËNIES

Metoda e mësimdhënies në masterin në të drejtën e biznesit përfshin një kombinim të teknikave dhe qasjeve që ndihmojnë në zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve. Disa nga metodat kryesore përfshijnë:

1

Orët e leksioneve

2

Studimi i rasteve

3

Grupet e Diskutimit

4

Simulimet

5

Projektet & Punët e Grupeve

6

Punë Praktike & Praktikë Profesionale

7

Seminaret

8

E-Learning & Platforma Online

9

Reflektimi & Feedback

10

Hulumtimi

INFORMACION PRAKTIK



PROGRAMI LËNDOR NË MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI

Programi i Masterit ofron një kurrikulë të gjerë prej 120 kredites ECTS që mbulon disa fushat kyçe për funksionimin dhe menaxhimin efikas të bizneseve. Ai përfshin 8 lëndë në vitin e parë dhe 7 lëndë në vitin e dytë, ndërsa kreditet e tjera fitohet përmes praktikës profesionale dhe provimit të diplomimit.

TË DHËNAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Profili: Menaxhim

VITI I	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Lidershipi në Organizatë (PhD Elida Motro (Iljazi))	6	Qeverisja e Korporatave (Prof. Asoc. Dr. Rezart Dibra)	6
	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar (Dr. Brikena Tolli)	6	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal (PhD Elida Motro (Iljazi))	6
	Menaxhim Projektsh (Dr. Elona Garo)	6	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit i Avancuar (Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli)	6
	Menaxhim Strategjik (Prof. Dr. Vasilika Kume)	6	Biznesi Ndërkombëtar (LZ) (PhD Gerti Dajçi)	6
	Vlerësimi Projekteve (Miranda Misini)	6	Praktikë Profesionale	6
	Total ECTS Semestri I	30	Total ECTS Semestri II	30
	Total ECTS			60

VITI II	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Taksimi i Biznesit (Dr. Abaz Aliko)	6	Menaxhimi Strategjik i Marketingut (LZ) (PhD Gerti Dajçi)	6
	Drejtimit Financiar i Avancuar (Dr. Abaz Aliko)	6	Praktikë Profesionale dhe Raporti i Përvojës Profesionale	6
	E Drejtë Biznesi e Avancuar (PhD Lorenc Gordani)	6	Temë Diplome/Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	18
	Marketing Ndërkombëtar (LZ) (Prof. Asoc. Dr. Altin Muça)	6		
	Komunikimi në Biznes (LZ) (PhD Ani Mbrica)	6		
	Total ECTS Semestri I	30	Total ECTS Semestri II	30
	Total ECTS			60

*Praktika profesionale zhvillohet paralelisht me zhvillimin e lëndëve në auditor, gjatë gjithë periudhës dyvjeçare të studimit.

Profili: Kontabilitet-Financë

VITI I	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Lidershipi në Organizatë (PhD Elida Motro (Iljazi))	6	Qeverisja e Korporatave (Prof. Asoc. Dr. Rezart Dibra)	6
	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar (Dr. Brikena Tolli)	6	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal (PhD Elida Motro (Iljazi))	6
	Menaxhim Projektsh (Dr. Elona Garo)	6	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit të Avancuar (Prof. Asoc. Dr. Indrit Baholli)	6
	Menaxhim Strategjik (Prof. Dr. Vasilika Kume)	6	E Drejta Fiskale dhe e Krahësuar (LZ) (Magjister. Maela Alicanaj)	6
	Vlerësimi Projekteve (Miranda Misini)	6	Praktikë Profesionale	6
	Total ECTS Semestri I	30	Total ECTS Semestri II	30
	Total ECTS			60

VITI II	SEMESTRI I		SEMESTRI II	
	Lëndët	ECTS	Lëndët	ECTS
	Taksimi i Biznesit (Dr. Abaz Aliko)	6	Tregjet e Kapitalit dhe Institucionet Financiare (LZ) (Prof. Dr. Elvin Meka)	6
	Drejtimit Financiar i Avancuar (Dr. Abaz Aliko)	6	Praktikë Profesionale dhe Raporti i Përvijës Profesionale	6
	E Drejtë Biznesi e Avancuar (PhD Lorenc Gordani)	6	Temë Diplome/ Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	18
	E Drejta Bankare dhe Financiare (LZ) (Prof. Dr. Elvin Meka, Enik Pogaçe)	6		
	Analiza Financiare (LZ) (Dr. Abaz Aliko)	6		
	Total ECTS Semestri I	30	Total ECTS Semestri II	30
	Total ECTS			60

*Praktika profesionale zhvillohet paralelisht me zhvillimin e lëndëve në auditor, gjatë gjithë periudhës dyvjeçare të studimit.

MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI

Kohëzgjatja:

2 vite akademike (4 semestra)

Forma e studimit:

Me kohë të plotë

Gjuha:

Shqip

Adresa:

📍 Rruga Rezervat e Shtetit,
Lundër, Tiranë, Shqipëri

☎ +355 69 70 66 966

✉ info@tbu.edu.al

🌐 www.tbu.edu.al

**DIPLOMA MASTER PROFESIONAL
NË ADMINISTRIM BIZNESI
(120 ECTS)**

KRITERET E PRANIMIT:

- Diplomë e nivelit Bachelor;
- CV;
- Letër Motivimi;
- Dokument Identifikimi.

*Për më shumë informacion dhe
për të aplikuar, vizitoni faqen
tonë të internetit:*

🌐 www.tbu.edu.al

Master i Shkencave
në Administrim Biznesi

KONTAKT:

DR. GERTI DAJÇI
Drejtor Akademik

✉ gerti.dajci@tbu.edu.al

☎ +355 69 935 4070